



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Pulsi Publik XVI Gusht 2019

Përpiluar nga UNDP në Kosovë Ekipi i Projektit Pulsi Publik

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve të anketës dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht as pikëpamjet e UNDP-së e as ato të USAID-it

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Treguesit kyç të Pulsit Publik	4
Drejtimi politik i Kosovës	4
Siguria personale	6
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	7
Drejtimi ekonomik	10
Problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova	11
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat	13
Korrupsioni në shkallë të gjerë	14
Qëndrimi kundrejt votimit	16
Mjedisi	20
Metodologjia	24
Peshimi i totaleve të popullatës	24
Përlllogaritja e Indekseve	25

Lista e figurave

Figura 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin politik të Kosovës	4
Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike	7
Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë	8
Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	9
Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës	12
Figura 6. Perceptimet për problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova	13
Figura 7. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik	14
Figura 8. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt atij privat	15
Figura 9. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë	17
Figura 10. Perceptimi i kosovarëve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	18
Figura 11. Perceptimi i burrave dhe grave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	18
Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	19
Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore do të mbaheshin së shpejti	20
Figura 14. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit sipas përkatësisë etnike	21
Figura 15. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër	22
Figura 16. Njohuritë e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, bazuar në përkatësinë e tyre etnike	23
Figura 17. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve	24
Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve, sipas përkatësisë etnike	24

Lista e tabelave

Tabela 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë	4
Tabela 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së	10
Tabela 3. Analiza e trendeve të komponenteve të IBE-së	11
Tabela 4. Perceptimet mbi prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë	16

Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhjet e Pulsit Publik ofrojnë vështrim për një numër të treguesve të matur përmes anketave të Pulsit Publik që hulumtojnë perceptimet e qytetarëve në lidhje me proceset demokratike, kushtet socio-ekonomike, dhe sigurinë. Anketat e Pulsit Publik përdorin metodologjinë tradicionale për ta shqyrtuar situatën socio-ekonomike në Kosovë dhe përmbledhjet e Pulsit Publik paraqesin treguesit kyç domethënës për stabilitetin politik dhe institucional, stabilitetin ekonomik dhe social, si dhe për sigurinë publike dhe personale. Së bashku, këta tregues mbërthejnë opinionin publik mbi çështjet kyçe zhvillimore, si dhe për performancën e institucioneve të ndryshme në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zberthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptime dhe problemet zhvillimore me të cilat përballen grupet e ndryshme. Më poshtë jepet përmbledhja e disa prej gjetjeve kryesore nga anketa e Pulsit Publik XVI.

Gjetjet e anketës së Pulsit Publik të majit 2019 tregojnë një rënie të përgjithshme të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve më kyçe ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore të Kosovës. Përjashtim bën niveli i kënaqshmërisë së të anketuarve me punën e Kryeministrit, i cili u rrit me 1.4% nga anketa e kryer në nëntor të vitit 2018. Vlen gjithashtu të theksohet se më shumë se gjysma e kosovarëve (62.8%) janë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Edhe pse niveli i pakënaqësisë me drejtimin politik të Kosovës në mesin e serbëve të Kosovës është pothuajse po aq i lartë sa në mesin e shqiptarëve të Kosovës, vullneti i tyre për të protestuar për arsye politike është më i ulët në krahasim me shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës. Indeksi i Demokratizimit (ID) dhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE), të cilët gjurmojnë opinionet e kosovarëve mbi proceset demokratike dhe perceptimet për kushtet mbizotëruese ekonomike, i kanë përjetuar uljet më të mëdha që nga shtatori 2015 dhe tetori 2016, përkatësisht: ID-ja e matur ishte në vlerën 1.02 dhe IBE-ja në 0.98, në një shkallë nga 0 (minimumi) deri në 3 (maksimumi).

Të dhënat tregojnë se shumica (70%) e kosovarëve ndihen të sigurt kur janë në rrugë. Të dhënat e zberthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat (73.6%) ndihen më të sigurta se meshkujt (67.2%) kur dalin në rrugë. Pavarësisht niveleve të ulëta të sigurisë të raportuara nga serbët e Kosovës (16.2%), të dhënat prapëseprapë tregojnë një rritje konsistente të atyre që ndihen të sigurt në rrugë nga nëntori 2018 (10.4%) dhe maji 2018 (4.8%). Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe problemet më të ngutshme me të cilat aktualisht përballen Kosova. Gjetjet tregojnë të njëjtat trende si në anketat e mëparshme, duke qenë se kosovarët raportuan papunësinë (37.9%), korrupsionin (16.6%) dhe varfërinë (13%) si tre çështjet themelore që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale. Serbët e Kosovës i konsiderojnë marrëdhëniet ndëretnike (26.7%), pasuar nga papunësia (11.4%) dhe krimi i organizuar (9%) si çështjet më thelbësore në Kosovë.

Gjithashtu, gjithsej 84% e të anketuarve – niveli më i lartë i regjistruar nga Pulsi Publik – konsiderojnë se punësimi në institucionet publike të Kosovës nuk bazohet në merita, kundrejt nëntorit të vitit 2018 kur 68.8% besonin një gjë të tillë. Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 10.6% thanë se dinë shumë për këtë temë, 40.4% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36.3% e të anketuarve thanë se dinë pak për këtë temë. Vetëm 12.7% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Dhe në fund kjo përmbledhje ofron edhe të dhëna për perceptimet e kosovarëve për korrupsionin në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik dhe atë privat, dhe qëndrimet ndaj votimit. Të dhënat shtesë të fituara përmes kësaj ankete dhe anketave të mëparshme do të jenë të disponueshme në [Platformën e vizualizimit të të dhënave të Pulsit Publik](#).

Treguesit kyç të Pulsit Publik

Rezultatet e anketës së Pulsit Publik të majit 2019 tregojnë rënie të ndjeshme të kënaqshmërisë së qytetarëve me institucionet kyçe të Kosovës krahasuar me anketat e opinionit të zhvilluara në nëntor 2018 dhe në maj 2018. Anketa e majit 2019 tregon se mesatarisht vetëm 22% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e institucioneve kyçe të Kosovës, gjë që përfaqëson një rënie prej 14 pikë përqindjeje krahasuar me anketat e nëntorit 2018 (36%) dhe 10 pikë përqindjeje krahasuar me anketat e majit 2018 (32.5%).

Rezultatet tregojnë një rënie dramatike të kënaqshmërisë me të gjitha institucionet, me përjashtim të atij të Kryeministrit. Më konkretisht, kënaqshmëria me punën e Kryeministrit (36.5%) është rritur me 1.4% krahasuar me nëntorin 2018 (35.1%). Megjithatë, krahasuar me nëntorin 2018, kënaqshmëria me punën e qeverisë ka rënë ndjeshëm, nga 31.3% në 17.7%, duke arritur nivelin më të ulët që nga prilli 2016. Një rënie e ngjashme në nivelet e kënaqshmërisë evidentohet në të gjitha institucionet e tjera. Për shembull, nivelet e kënaqshmërisë me punën e Kuvendit kanë rënë nga 36.1% në nëntor 2018 në 19.6%. Kënaqshmëria me Kryetarin e Kuvendit ka rënë në 23.6% nga 36.3% në nëntor 2018. Niveli i kënaqshmërisë me punën e Presidentit ka rënë në 20.4%, krahasuar me 38.4% në nëntor 2018. Në mënyrë të ngjashme është përmbysur edhe niveli i kënaqshmërisë me gjykatat dhe Prokurorinë e Shtetit, nga rritja e nivelit të kënaqshmërisë në nëntor 2018 (37.8% dhe 35.3% përkatësisht) në një rënie të lirë në 18.7% për gjykatat dhe 16.4% për Prokurorinë e Shtetit.

Tabela 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

Treguesit politikë	Mar 07	Maj 08	Qer 09	Pri 10	Nën 10	Qër 12	Tet 12	Pri 13	Pri 14	Nën 14	Mar 18	Shta 15	Pri 16	Tet 16	Tet 17	Maj 18	Nën 18	Maj 19	Trend	
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Qeveria	30.5 %	46.9 %	53.1 %	29.2 %	25.1 %	32.6 %	27.2 %	27.0 %	44.2 %	19.3 %	18.1 %	17.3 %	17.8 %	20.2 %	32.4 %	30.0 %	31.3 %	31.3 %	
	Kryeministri	54.0 %	72.0 %	53.8 %	36.4 %	30.7 %	37.6 %	27.3 %	30.4 %	48.5 %	34.1 %	23.6 %	14.6 %	18.3 %	19.7 %	42.3 %	33.2 %	35.1 %	36.5 %	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	31.0 %	51.4 %	53.2 %	34.1 %	32.1 %	41.0 %	32.1 %	32.3 %	46.5 %	16.1 %	19.3 %	19.9 %	17.3 %	18.9 %	31.7 %	32.9 %	36.1 %	19.6 %	
	Kryetari i Kuvendit	35.4 %	56.5 %	51.6 %	36.0 %	33.3 %	60.9 %	44.7 %	45.8 %	57.8 %	23.3 %	20.1 %	19.8 %	24.3 %	24.9 %	36.0 %	31.5 %	36.3 %	23.6 %	
Kënaqshmëria me Presidentin	Presidenti	52.0 %	74.0 %	61.7 %	54.9 %	30.8 %	54.1 %	47.1 %	45.1 %	48.8 %	40.7 %	30.2 %	30.4 %	45.7 %	25.5 %	37.6 %	39.1 %	38.4 %	20.4 %	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	20.0 %	21.0 %	32.7 %	27.2 %	18.5 %	26.9 %	24.3 %	16.7 %	37.5 %	22.8 %	17.2 %	13.9 %	18.4 %	22.1 %	36.9 %	31.2 %	37.8 %	18.7 %	
	Prokuroria	22.7 %	22.7 %	31.7 %	26.9 %	15.1 %	20.0 %	15.0 %	17.7 %	38.1 %	21.0 %	17.0 %	12.8 %	16.9 %	16.3 %	33.1 %	29.9 %	35.3 %	16.4 %	

Drejtimi politik i Kosovës

Në përputhje me uljen e kënaqshmërisë me institucionet kyçe politike dhe gjyqësore, ekziston një nivel i lartë i pakënaqësisë me drejtimin politik të Kosovës. Më shumë se gjysma e të anketuarve (62.84%) janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Ky nivel i pakënaqësisë është rritur me 12 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2018 dhe majin 2018. Niveli i matur i kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës arrin vetëm 6.21%, duke shënuar një rënie prej 7% krahasuar me nëntorin 2018 dhe prej 9% krahasuar me majin 2018. Pothuajse një e treta e të gjithë të anketuarve (30.95%) deklaruan se kanë një pikëpamje neutrale, duke shënuar një rënie prej gati 6% krahasuar me nëntorin 2018, siç tregohet në Figurën 1.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat janë pak më të kënaqura sesa meshkujt me drejtimin politik të Kosovës. Ndërkohë që 12% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 8.5% e meshkujve kanë deklaruar se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se 10.1% e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, ndërsa vetëm 7.6% e serbëve të Kosovës tregojnë të njëjtin nivel kënaqshmërie. Gjithsej 15.5% e të anketuarve nga komunitetet e tjera kosovare (boshnjakët e Kosovës, turqit e Kosovës, goranët e Kosovës, romët e Kosovës, egjiptasit e Kosovës dhe ashkalitë e Kosovës) deklaruan se janë të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Niveli më i lartë i pakënaqësisë gjendet në mesin e shqiptarëve të Kosovës (60.7%), të ndjekur nga serbët e Kosovës (59.6%) dhe nga komunitetet tjera të Kosovës (58.4%). Përqindja e shqiptarëve të Kosovës dhe e serbëve të Kosovës që janë neutralë është e njëjtë, në vlerat 28.7% dhe 28.6% përkatësisht, ndërsa të anketuarit neutralë nga komunitetet e tjera të Kosovës janë 36%.




Figura 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin politik të Kosovës

Përveç pakënaqësisë në rritje me drejtimin politik të Kosovës, ka një rritje të gatishmërisë së kosovarëve për t'iu bashkuar protestave politike, pasi 42.2% e të anketuarve deklaruan se ishin të gatshëm t'iu bashkohen protestave politike. Ky numër është rritur me 2.7% krahasuar me nëntorin 2018, dhe është 4.4% më i lartë se në maj 2018. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Në mënyrë të veçantë, 43.7% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 13.3% të serbëve të Kosovës dhe 35% të komuniteteve të tjera të Kosovës. Vërehet se megjithëse niveli i pakënaqësisë me drejtimin politik të Kosovës në mesin e serbëve të Kosovës është pothuajse po aq i lartë sa në mesin e shqiptarëve të Kosovës, vullneti i tyre për të protestuar për arsye politike është më i ulët krahasuar me shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës. Ky trend u regjistrua edhe në anketën e opinionit të Pulsit Publik të nëntorit 2018, ndonëse gatishmëria e serbëve të Kosovës për të protestuar është rritur me 9.3% krahasuar me nëntorin 2018.

Protesta Politike




Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

Siguria personale

Për ta matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe kimit potencial. Gjetjet tregojnë një ndryshim të papërfillshëm, nga 70.7% në nëntor 2018 në 70.4% në maj 2019, në ndjenjën e sigurisë kur janë në rrugë. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë një ndryshim të vogël mes meshkujve dhe femrave në perceptimin e sigurisë. Gjithsej 67.2% e meshkujve dhe 73.6% e femrave deklaruan se ndihen të sigurt kur dalin në rrugë. Kjo gjetje është veçanërisht e rëndësishme, sepse kjo është hera e parë që një përqindje më e lartë e femrave sesa e meshkujve raportojnë se ndihen të sigurt kur dalin në rrugë. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime më të mëdha. Për shembull, 69.7% e shqiptarëve të Kosovës dhe 57% e komuniteteve tjera të Kosovës ndihen të sigurt kur janë në rrugë, krahasuar me vetëm 16.2% të serbëve të Kosovës. Pavarësisht niveleve të ulëta të sigurisë të raportuara nga serbët e Kosovës, të dhënat tregojnë një rritje konsistente nga nëntori 2018 (10.4%) dhe maji 2018 (4.8%). Ndryshe nga përqindja e shtuar e serbëve të Kosovës që deklaruan se ndihen të sigurt në rrugë, përqindja e shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës ka rënë nga nëntori 2018 (72% e shqiptarëve të Kosovës dhe 61% e komuniteteve të tjera në Kosovë).




Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Në përputhje me trendet e tjera në rënie të regjistruara nga anketa e fundit e opinionit, anketa e opinionit të Pulsit Publik XVI ka shënuar një rënie të ndjeshme si në ID ashtu edhe në IBE. Më konkretisht, ID-ja aktuale është 1.02, çka do të thotë se ka rënë me 0.47 pikë nga 1.49 pikë të regjistruara në nëntor 2018. ID-ja aktuale ka arritur pikën më të ulët nga shtatori 2015 (1.02). Kjo shifër sugjeron se gati dy të tretat e kosovarëve kanë pikëpamje negative për proceset demokratike në Kosovë.

Një rënie e ngjashme mund të vërehet në IBE, që ka rënë nga 1.4 në 0.98, duke sugjeruar se më shumë se dy të tretat e kosovarëve nuk kanë pikëpamje pozitive për trendet ekonomike. IBE-ja aktuale ka vlerën më të ulët të regjistruar që nga tetori 2016 (0.94).




Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja përbëhen nga një numër komponentesh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponente të paraqitura në Tabelën 2. Pyetjeve që bien brenda fushëveprimit të këtij indeksi mund t'u përgjigjemi me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, kryesisht" ose "Po, plotësisht" në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e ID-së, të dhënat nga maji 2019 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se çdo komponent i ID-së i listuar në Tabelën 2 ka dëshmuar rënie prej nëntorit 2018.

Vetëm 35.6% e kosovarëve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 53.7% dhe 50.9% në nëntor 2018 dhe maj 2018 përkatësisht. Shumica e kosovarëve (61.9%) konsiderojnë se Kuvendi nuk e monitoron punën e qeverisë, dhe vetëm 38.1% besojnë se Kuvendi e monitoron qeverinë. Kjo vlerë e fundit ka shënuar një rënie prej 10.2% nga anketa e opinionit e nëntorit 2018 (48.3%).

Vetëm 21.5% e të anketuarve konsiderojnë se gjyqësori është i pavarur në vendimet e tij, krahasuar me 46% që e besonin këtë në nëntor 2018. Në fakt, përqindja aktuale është më e ulëta që nga prilli 2016 (21%).

Gjithsej 45% e të anketuarve konsiderojnë se mediat gëzojnë lirinë e shprehjes, duke e bërë këtë komponentin më të vlerësuar pozitivisht të ID-së. Megjithatë, kur krahasohet me nëntorin 2018, ka një rënie prej 13.5% pikë përqindjeje të atyre që konsiderojnë se mediat e gëzojnë lirinë e shprehjes. Një rënie e theksuar vërehet në perceptimet për rolin e shoqërisë civile si një monitorues i singertë i qeverisë: 32.6% e të anketuarve kanë një opinion pozitiv krahasuar me nëntorin 2018, kur 57.5% e të anketuarve kishin mendim pozitiv për rolin e shoqërisë civile si monitorues i singertë i qeverisë.

Vetëm 29.8% dhe 18.1% e të anketuarve mendojnë se institucionet lokale dhe qendrore punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës, krahasuar me 49.2% dhe 37.5% të regjistruar në anketat e Pulsit Publik të nëntorit 2018 dhe majit 2018. Në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse ato përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, regjistrohet një rënie prej 27.1% në përgjigjet pozitive (33.4% në maj 2019 kundrejt 60.5% në nëntor 2018).

¹ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga ⁰ në ³, në të cilat një rezultat nga ⁰ në ¹⁵ nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokracinë apo trendet ekonomike dhe rezultati nga ¹⁵ në ³ nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike

Dhe ne fund në përputhje me rënien e përgjigjeve pozitive në lidhje me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 22.4% e të anketuarve besojnë se proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur. Kjo është rënia më e lartë (34.8%) krahasuar me komponentet tjera që përbëjnë ID-në. Në anketën e opinionit të nëntorit 2018, përgjigje pozitive kishin dhënë 57.2% e të anketuarve. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shumica e serbëve të Kosovës iu përgjigjën këtyre pyetjeve me “aspak”, “jo aq shumë”, ose “nuk e di” dhe kanë refuzuar t’u përgjigjen këtyre pyetjeve.

Tabela 2. Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	Nën 10	Qer 11	Nën 11	Pri 12	Tet 12	Pri 13	Pri 14	Nën 14	Mar 15	Shta 15	Pri 16	Tet 16	Tet 17	Maj 18	Nën 18	Maj 19	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	31.0 %	29.3 %	23.1 %	17.0 %	16.2 %	15.0 %	36.4 %	34.0 %	26.2 %	23.0 %	30.3 %	28.0 %	44.6 %	50.9 %	53.7 %	35.6 %	
A e monitoron Kuvendi performancën e qeverisë?	20.7 %	20.7 %	19.4 %	16.7 %	17.7 %	17.5 %	28.5 %	21.5 %	21.2 %	21.8 %	26.6 %	30.8 %	36.1 %	50.9 %	46.7 %	38.1 %	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.2 %	15.6 %	11.3 %	12.3 %	15.7 %	10.6 %	24.8 %	16.0 %	13.6 %	17.6 %	21.0 %	21.6 %	31.2 %	43.6 %	46.0 %	21.5 %	
A e gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	29.2 %	33.9 %	33.3 %	34.7 %	37.3 %	24.6 %	45.4 %	39.6 %	35.5 %	46.5 %	47.3 %	42.3 %	52.5 %	52.8 %	59.1 %	45.6 %	
A shërben Shoqëria civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike ?	22.6 %	18.9 %	20.3 %	19.0 %	24.4 %	18.3 %	28.8 %	21.3 %	19.5 %	23.1 %	32.1 %	30.1 %	34.4 %	48.3 %	57.5 %	32.6 %	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës	27.7 %	26.7 %	29.0 %	25.7 %	27.3 %	26.1 %	32.6 %	29.5 %	23.3 %	27.2 %	28.9 %	30.4 %	34.0 %	50.2 %	49.2 %	29.8 %	
A funksionon qeverisja e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës	14.3 %	16.1 %	14.5 %	12.9 %	15.3 %	16.4 %	26.4 %	18.2 %	11.8 %	15.5 %	18.9 %	17.9 %	24.7 %	39.9 %	37.5 %	18.1 %	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	32.6 %	27.9 %	26.5 %	25.9 %	26.0 %	33.0 %	35.3 %	24.2 %	23.5 %	19.8 %	31.7 %	31.8 %	41.4 %	53.4 %	60.5 %	33.4 %	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt së ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	25.6 %	24.5 %	17.9 %	18.1 %	18.6 %	23.0 %	33.0 %	19.5 %	17.3 %	15.4 %	23.1 %	23.8 %	29.7 %	46.9 %	57.2 %	22.4 %	

Ngjashëm, për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive të komponenteve të IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3.. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë "të favorshme", "jo të favorshme" dhe "neutrale". Edhe në IBE është vërejtur një rënie e ngjashme e në të gjithë treguesit si në ID. Për shembull, vetëm 11.6% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve, duke shënuar një rënie prej 7.2% nga nëntori 2018, dhe duke qenë vlera më e ulët që nga prilli 2013. Vetëm 5.5% e të anketuarve i shohin kushtet për të bërë biznes në Kosovë në mënyrë të favorshme - një rënie prej 16.7%, duke kapur vlerën më të ulët që nga prilli 2013. Ngjashëm, vetëm 5.8% e të anketuarve i shohin kushtet aktuale të punësimit në mënyrë të favorshme - niveli më i ulët i regjistruar që nga prilli 2013. Dhe në fund, 4.6% e të gjithë të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet e ardhshme të punësimit gjashtë muaj pas anketës (maj 2019), i cili është niveli më i ulët i regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik. Një rënie e tillë drastike në treguesit e IBE-së sugjeron një pikëpamje mjaft pesimiste të koso-varëve në lidhje me ekonominë.

Tabela 3. Analiza e trendeve të komponenteve të IBE-së

I Favorshëm	Nën 10	Qer 11	Nën 11	Pri 12	Tet 12	Pri 13	Pri 14	Nën 14	Mar 15	Shta 15	Pri 16	Tet 16	Tet 17	Maj 18	Nën 18	Maj 19	Trendi
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot	16.8 %	12.1 %	8.5 %	9.9 %	9.6 %	7.6 %	17.0 %	19.7 %	15.1 %	15.9 %	23.4 %	18.0 %	22.4 %	19.9 %	18.8 %	11.6 %	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale te biznesit	10.7 %	9.7 %	6.0 %	7.9 %	6.7 %	4.8 %	11.6 %	8.8 %	8.1 %	8.3 %	14.4 %	13.1 %	17.9 %	18.5 %	16.7 %	5.5 %	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale te punësimit	4.0 %	3.3 %	3.8 %	3.4 %	3.8 %	5.1 %	9.2 %	7.7 %	5.0 %	6.8 %	10.3 %	7.7 %	17.1 %	15.4 %	15.9 %	5.8 %	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot	14.3 %	12.4 %	8.0 %	7.6 %	7.4 %	6.4 %	13.7 %	7.3 %	6.0 %	8.0 %	14.0 %	10.7 %	18.7 %	17.8 %	23.3 %	4.6 %	

Drejtimi ekonomik

Vetëm 10.4% e të anketuarve janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, duke shënuar rënie nga vlera prej 12.3% që është regjistruar në nëntor 2018.

Ndërkohë që 60.4% e të anketuarve janë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, 29.2% nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më të kënaqura sesa meshkujt me drejtimin ekonomik të Kosovës: 7.4% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura, kundrejt 5% të meshkujve që janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Rrjedhimisht, 65% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 58.3% të femrave që ndihen njësoj. Ndërkohë që 28.2% e meshkujve dhe 32.9% e femrave janë neutrale në lidhje me këtë çështje, një përqindje e papërfillshme e të anketuarve nuk e di ose nuk ka pranuar t'i përgjigjet pyetjes. Kur nivelet e kënaqshmërisë u analizuan përgjatë vijave etnike, të dhënat sugjerojnë se serbët e Kosovës janë më të pakënaqur (70.9%) sesa shqiptarët e Kosovës (61.9%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (56%). Shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës ndajnë pothuajse të njëjtat nivele të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës: shqiptarët e Kosovës shënojnë 6.5 pikë përqindje dhe komunitetet e tjera të Kosovës shënojnë 6.2 pikë përqindjeje. Një dallim vërehet tek serbët e Kosovës, kënaqshmëria e të cilëve me drejtimin ekonomik është 4.3%.




Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

Problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova

Papunësia, korrupsioni dhe varfëria janë renditur si tre problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova. Problemi më i madh për 37.9% të të anketuarve është papunësia, krahasuar me 29.4% në nëntor 2018 dhe 39.6% në tetor 2017. Në vijim, 16.6% e të anketuarve identifikuan korrupsionin si problemin më të madh, krahasuar me 13.4% në nëntor 2018 dhe 16.7% në tetor 2017. Përfundimisht varfëria mbetet problemi më i madh për 13% të të anketuarve, krahasuar me 8.6% në nëntor 2018 dhe 9.4% në tetor 2017. Me përjashtim të vitit 2017, papunësia, korrupsioni dhe varfëria kanë qenë vazhdimisht tri çështjet problematike më të përmendura në përmbledhjet e Pulsit Publik gjatë viteve të fundit. Gjetjet e tjera tregojnë se rreth 2.8% e të anketuarve konsiderojnë se shërbimet shëndetësore janë një problem themelor, 2.6% e të anketuarve e konsiderojnë arsimin si një problem themelor, kurse 2.2% e të anketuarve e konsiderojnë krimin e organizuar si çështjen më të ngutshme në Kosovë.

Ndërkohë që raportet e mëparshme nuk shënuan ndonjë dallim gjinor mes opinionëve të femrave dhe meshkujve mbi problemet themelore, të dhënat e zërthyerë sipas gjinisë në anketën e opinionit të majit 2019 tregojnë se femrat (39.8%) janë më të shqetësuara sesa meshkujt (35.9%) për papunësinë. Megjithatë, meshkujt (13.5%) janë pak më të shqetësuar sesa femrat (12.7%) për varfërinë. Së fundmi, meshkujt janë më të shqetësuar për korrupsionin me 3.7 pikë përqindjeje krahasuar me femrat - duke shënuar 18.4% kundrejt 14.7%.

Të dhënat e zërthyerë sipas përkatësisë etnike tregojnë dallimet në renditjen e problemeve themelore ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës, nga njëra anë, dhe serbëve të Kosovës nga ana tjetër. Shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës e kanë renditur papunësinë, korrupsionin dhe varfërinë si tre problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova. Për dallim, serbët e Kosovës i konsiderojnë marrëdhëniet ndëretnike (26.7%), pasuar nga papunësia (11.4%) dhe krimi i organizuar (9%) si çështjet më të ngutshme në Kosovë.




Figura 6. Perceptimet për problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht

Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat

Ka një rënie prej 15.2% në perceptimin e kosovarëve në lidhje me punësimin me baza meritore në sektorin publik në Kosovë, dhe një rritje prej 15.2% në numrin e atyre që konsiderojnë se punësimi në institucionet publike nuk bëhet në baza meritore. Vetëm 16% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me nëntorin 2018, kur 31.2% e konsideronin këtë të vërtetë. Njëkohësisht, 84% e të anketuarve - niveli më i lartë i regjistruar nga Pulsi Publik - konsiderojnë se punësimi në institucionet publike të Kosovës nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me nëntorin 2018, kur 68.8% besonin se kjo ishte e vërtetë. Faktorët kryesorë jo meritore për të fituar punësim në sektorin publik konsiderohen lidhjet familjare (31.6%), lidhja partiake (30.1%), ryshfeti (16.3%), miqtë dhe, në një masë më të vogël, pamja. Vetëm 16.1% besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm në sigurimin e punësimit në sektorin publik. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë dallim të vogël në perceptimet e meshkujve dhe femrave në lidhje me sigurimin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime ndërmjet perceptimeve të komuniteteve të ndryshme. Për shembull, ndërkohë që vetëm 14.6% e shqiptarëve të Kosovës dhe 24% e të anketuarve nga komunitetet e tjera të Kosovës deklaruan se përvoja profesionale, aftësimi profesional dhe arsimimi janë faktorë të rëndësishëm për të siguruar një vend pune, të njëjtën gjë e besojnë 32% e serbëve të Kosovës.




Figura 7. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Sa i përket sektorit privat, 34% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat fitohet sipas kriterëve me bazë meritore, siç janë përvoja profesionale, arsimimi dhe aftësi profesionale. Kjo është dyfishi i numrit të atyre që mendojnë të njëjtën gjë rreth punësimit në sektorin publik (16.1%). Megjithatë, 65.8% e të anketuarve besojnë se lidhjet familjare (32%), miqtë (15.6%) dhe, në një masë më të vogël, ryshfeti (7.2%), lidhjet partiake (6.2%) dhe pamja (4.1%) janë faktorë jo meritorë për të siguruar punësim në sektorin privat.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të mëdha në mes të meshkujve dhe femrave në lidhje me meritokracinë në sektorin privat të Kosovës. Megjithatë, të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se 32.5% e shqiptarëve të Kosovës, 40.5% e serbëve të Kosovës dhe 35% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, besojnë se faktorët meritorë, si përvoja profesionale, arsimimi dhe aftësi profesionale, janë çelësi për gjetjen e një pune në sektorin privat në Kosovë.




Figura 8. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt atij privat

Korrupsioni në shkallë të gjerë

Mesatarisht, 30% e të anketuarve pohuan se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë paraqet një rritje prej 5% në nivelet e korrupsionit të perceptuar në shkallë të gjerë nga nëntori 2018 (mesatarisht 25%) dhe perceptimi i ngjashëm për nivelin e korrupsionit në maj 2018 (mesatarisht 31%), siç tregohet në tabelën 4.

Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë luhaten nga vlera më e ulët prej 17% e të anketuarve që pretendojnë se është i përhapur në Policinë e Kosovës, tek vlera më e lartë prej 44.2% e të anketuarve që pretendojnë se është i përhapur në Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK). Ndryshimet më të mëdha në perceptime janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: PTK (44.2% krahasuar me 25.6% në nëntor 2018), Agjencia Kosovare e Privatizimit (40.7% krahasuar me 29.8% në nëntor 2018) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (35.3% krahasuar me 25.4% në nëntor 2018). Megjithatë, tre institucionet kryesore me nivelin më të lartë të korrupsionit të perceptuar në shkallë të gjerë janë PTK (44.2%), Agjencia Kosovare e Privatizimit (40.7%) dhe Shpërndarja dhe Furnizimi me Energji Elektrike në Kosovë (40.7%). Institucionet me vlerat më të ulëta të korrupsionit të perceptuar në shkallë të gjerë janë Policia e Kosovës (17%), organizatat ndërkombëtare (19.5%), institucionet arsimore (20.7%) dhe policia e EULEX-it (22.5%).

Poashtu ia vlen të theksohet se perceptimi për korrupsionin në disa institucione ka kaluar nëpër disa ndryshime të dukshme me kalimin e viteve. Për shembull, perceptimi mbi praninë e korrupsionit në kujdesin shëndetësor ka rënë për më pak se gjysma nga nëntori i vitit 2015 (56.2%) deri në maj 2019 (25.1%). Komunitet kanë kaluar nëpër një rënie të qëndrueshme në perceptimin mbi korrupsionin i cili ka rënë nga 40.2% në tetor të vitit 2016 në 25.8% në maj të vitit 2019. Edhe qeverisja qendrore ka përjetuar rënie në perceptimin në lidhje me korrupsionin nga 49.2% në tetor të vitit 2016 në 36.7% në maj të vitit 2019, por e ka përjetuar një ngritje në perceptimin mbi praninë e korrupsionit për 8% nga nëntori i vitit 2018 (28.4%) në maj të vitit 2019.

Tabela 4. Perceptimet për shtrirjen e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

	Nën 10	Qer 11	Nën 11	Pri 12	Tet 12	Pri 13	Pri 14	Nën 14	Mar 15	Shta 15	Pri 16	Tet 16	Tet 17	Maj 18	Nën 18	Maj 19	Trendi
Shëndetsia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	47.9%	40.7%	49.8%	43.3%	51.6%	50.4%	40.4%	56.2%	52.6%	51.5%	37.9%	49.7%	25.5%	32.5%	25.7%	25.1%	
KEDS	52.4%	47.9%	61.2%	47.8%	53.8%	48.8%	24.4%	39.1%	44.7%	35.6%	31.1%	31.4%	20.5%	33.0%	31.3%	40.7%	
Gjykatat	49.7%	41.6%	55.6%	44.5%	47.5%	56.4%	32.2%	42.1%	42.9%	46.9%	42.3%	49.3%	24.9%	38.6%	29.1%	30.7%	
Doganat	45.1%	42.3%	53.7%	43.2%	49.9%	58.9%	22.5%	33.4%	38.7%	41.3%	32.3%	45.2%	22.7%	39.1%	31.4%	29.3%	
Administrata qendrore/ qeveria	47.5%	41.4%	43.3%	39.5%	35.7%	46.1%	24.0%	37.5%	38.5%	36.0%	36.6%	49.2%	30.7%	34.7%	28.4%	36.7%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	52.0%	40.5%	51.9%	49.4%	46.4%	48.7%	24.6%	34.8%	37.1%	38.3%	39.2%	45.7%	24.9%	34.5%	29.8%	40.7%	
Komunitet (qeverisja lokale)	32.9%	30.4%	31.9%	30.1%	32.2%	38.9%	20.6%	33.2%	33.8%	28.6%	30.0%	40.2%	25.5%	29.0%	26.4%	25.8%	
Policia e EULEXI-it (CIVPOL)	22.9%	26.2%	27.1%	28.3%	28.7%	38.3%	11.1%	16.5%	32.2%	35.2%	28.8%	34.1%	20.9%	29.9%	20.9%	22.5%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	14.4%	13.1%	17.3%	26.2%	23.5%	31.6%	13.0%	24.3%	29.3%	29.0%	17.5%	31.0%	16.3%	26.2%	19.9%	20.7%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)		24.9%	36.5%	38.1%	33.6%	42.5%	16.5%	28.0%	28.1%	25.0%	18.2%	32.5%	17.4%	28.9%	25.4%	35.3%	
PTK	34.0%	32.4%	46.6%	41.8%	45.1%	41.4%	15.4%	21.3%	25.9%	25.2%	18.4%	29.6%	17.0%	27.8%	25.6%	44.2%	
Bankat	14.4%	14.9%	22.0%	20.5%	22.8%	37.5%	12.0%	17.0%	24.3%	23.3%	23.1%	24.4%	13.1%	27.3%	26.1%	33.8%	
Organizatat ndërkombëtare	14.7%	12.3%	20.3%	19.3%	20.8%	24.8%	10.8%	16.2%	20.4%	22.9%	16.0%	28.0%	10.8%	24.5%	10.7%	19.5%	
Policia e Kosovës (PK)	15.2%	15.5%	19.5%	19.4%	28.0%	30.3%	11.5%	16.1%	20.4%	19.0%	13.6%	21.1%	14.9%	25.7%	21.6%	17.0%	

Të anketuarit u pyetën për arsyet e vlerësimit të shkallës së korrupsionit për të kuptuar se çfarë i formëson perceptimet e tyre mbi praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve (51.1%) i kanë formuar mendimet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron në Figurën 9. Rreth 41% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë kanë formuar bazën e mendimeve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit. Më shumë se 7% e të anketuarve deklaruan se i kanë formuar mendimet e tyre në bazë të përvojave personale, përkatësisht prej tyre janë kërkuar para, dhurata apo favore të tjera për të marrë shërbime të caktuara.




Figura 9. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre mbi shtrirjen e korrupsionit në Kosovë

Qëndrimi kundrejt votimit

Anketa e opinionit e Pulsit Publik hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (49%) deklaruan se votimi i tyre nuk mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 46% në nëntor 2018 dhe 43% në maj 2018. Vetëm 3.8% nuk e dinë nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 16.8% besojnë se votimi i tyre mund të ndikojë në ndryshime, dhe 29.7% mendojnë se votimi i tyre mund ta ndryshojë situatën deri në një farë mase. Krahasuar me nëntorin 2018 (34%) dhe majin 2018 (32%), numri i atyre që konsiderojnë se votimi i tyre mund të ndikojë në ndryshime, është shumë më i ulët.




Figura 10. Perceptimi i kosovarëve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më skeptike sesa meshkujt kur është fjala për ndikimin e votës së tyre. Derisa 18.4% e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, vetëm 15.1% e femrave mendojnë të njëjtën gjë. Për dallim nga 47% e meshkujve, shumica e femrave (51%) mendojnë se votimi i tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.




Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe i femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në besimin në zgjedhje si një mekanizëm për të bërë ndryshime pozitive në Kosovë. Vetëm 3.8% e serbëve të Kosovës konsiderojnë se vota e tyre mund të ndikojë në ndryshimet në Kosovë, përkundrajt 17.5% të shqiptarëve të Kosovës dhe 12% të komuniteteve të tjera të Kosovës.

Të anketuarit serbë të Kosovës paraqesin përqindjen më të ulët dhe trendin më të madh në rënie (31.9% kundrejt 61.5% në nëntor 2018) të atyre që nuk besojnë se votimi i tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, krahasuar me shqiptarët e Kosovës (49.3%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (58%). Gjithsej 23.8% e serbëve të Kosovës nuk e dinë nëse vota e tyre mund të ndikojë në ndryshime në Kosovë, ndërsa 15.7% nuk kanë pranuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Ndërkohë, 2.7% e shqiptarëve të Kosovës dhe 10% e komuniteteve tjera të Kosovës nuk e dinin nëse vota e tyre mund të ndikojë në ndryshimet në Kosovë, dhe një përqindje e papërfillshme prej 0.1% dhe 0.5% nuk kanë pranuar të përgjigjen.




Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe për gjasat e të anketuarve për të votuar dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 73.5% e të anketuarve (krahasuar me 69% në nëntor 2018 dhe 63% në maj 2018) do të votonin për një parti të caktuar politike, ose për një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkohë që 11.7% e të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë preferencë politike, 11.4% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin, ashtu si në nëntor 2018, dhe 3.4% nuk iu përgjigjën pyetjes.




Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore do të mbaheshin së shpejti

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se nuk ka dallime të konsiderueshme në mes të meshkujve dhe femrave në lidhje me gjasat e tyre për të votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti. Megjithatë, të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se më shumë serbë do të votonin tani sesa gjashtë muaj më parë: 32.7% e serbëve të Kosovës do të votonin, krahasuar me 21% në nëntor 2018, kundrejt 75.5% të shqiptarëve të Kosovës dhe 71.2% të komuniteteve të tjera të Kosovës. Një numër mjaft më i madh i serbëve të Kosovës (30.8%) nuk do të votonin, krahasuar me 10.6% të shqiptarëve të Kosovës dhe 11.5% të komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjithsej 2.6% e shqiptarëve të Kosovës, 13.5% e serbëve të Kosovës dhe 11.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës nuk u përgjigjen, ndërsa 11.4% të shqiptarëve të Kosovës, 23.1% të serbëve të Kosovës dhe 5.8% e komuniteteve të tjera të Kosovës nuk kishin asnjë preferencë politike.




Figura 14. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit sipas përkatësisë etnike

Mjedisi

Vetëdijesimi i publikut në lidhje me nevojën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm është një çelës për politikën që nxisin mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, si dhe kujdesin e qytetarëve për mjedisin në të cilin jetojnë. Të anketuarit u pyetën për njohurinë e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe më të pastër. Gjithsej 10.6% thanë se dinë shumë për këtë temë, 40.4% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36.3% e të anketuarve thënë se dinë pak për këtë temë. Vetëm 12.7% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Nuk ka ndryshim të madh krahasuar me nëntorin 2018, kur u prezantuan për herë të parë pyetjet për mjedisin, me përjashtim të përqindjes së atyre që nuk kanë njohuri, e cila ka rënë nga 18.1% në 12.7% në anketën e muajit maj 2019.




Figura 15. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime thelbësore në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 25.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës, 23.3% e serbëve të Kosovës, dhe vetëm 11.7% e shqiptarëve të Kosovës, pretendojnë se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh në mes të nëntorit 2018 (46.9%) dhe majit 2019 (23.3%) është rënia e numrit të serbëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për temën. Komunitetet e tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri mbi këtë temë (25.5%). Shqiptarët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve (37.2%) që kanë pak njohuri për këtë çështje; serbët e Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve (48.6%) që kanë njohuri mesatare për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm; ndërsa shqiptarët e Kosovës udhëheqin në njohuritë e shumta për këtë çështje (10.8%), të ndjekur nga afër nga serbët e Kosovës (9.5%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (5.5%).




Figura 16. Njohuritë e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, sipas përkatësisë etnike

Pyetja e dytë lidhur me mjedisin ka të bëjë me vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore për shëndetin e vet dhe të familjes së tyre. Ndërkohë që 8% e të anketuarve thanë se ishin plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 77.9% e të anketuarve thanë se kishin pak njohuri ose njohuri mesatare për këto kërcënime, dhe 14.1% thanë se nuk kishin njohuri për kërcënimet e mundshme mjedisore për shëndetin e vet dhe të familjes. Nuk ka dallim të dukshëm në njohuritë e të anketuarve krahasuar me anketën e opinionit të nëntorit 2018. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se 16.2% e femrave dhe 12% e meshkujve nuk kanë njohuri për këtë çështje, dhe se femrat kanë njohuri më pak se mesatarja krahasuar me meshkujt për 3.6%. Tregues të tjerë tregojnë vlera të njëjta mes femrave dhe meshkujve.




Figura 17. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve

Siç shihet në Figurën 18, të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet ndërmjet grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore për shëndetin e vet dhe të familjes. Gjithsej 23% e komuniteteve të tjera të Kosovës, 22.9% e serbëve të Kosovës, dhe vetëm 13.3% e shqiptarëve të Kosovës, pretendojnë se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh mes nëntorit 2018 (45.5%) dhe majit 2019 (22.9%) është rënia e numrit të serbëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për temën. Komunitetet e tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri (23.3%) ose kanë pak njohuri (46%) për temën. Serbët e Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve (40%) që kanë njohuri mesatare rreth kërcëni-meve të mundshme mjedisore për shëndetin e vet dhe të familjes. Në fund, shqiptarët e Kosovës udhëheqin në njohuritë e shumta në lidhje me këtë çështje me 8%, pasuar nga afër nga serbët e Kosovës me 7.6%, dhe komunitetet e tjera të Kosovës me 6%.




Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve, sipas përkatësisë etnike

Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje janë bazuar në anketën e opinionit në të cilën u anketuan 1,306 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçare. Në mostër janë përfshirë të dyja gjinitë, meshkuj dhe femra nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat urbane dhe rurale. Konkretisht, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës, përkatësisht turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, ashkali të Kosovës, dhe egjiptas të Kosovës. Anketa u bazua në mostrimin me proba-bilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe është zhvilluar në maj 2019. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.

Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të minoriteteve në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas të Kosovës): 6%

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej Popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptar të Kosovës	1,616,869	92.93 %
Serb të Kosovës	25,532	1.47 %
Turq të Kosovës	18,738	1.08 %
Boshnjak të Kosovës	27,533	1.58 %
Goran të Kosovës	10,265	0.59 %
Romë të Kosovës	8,824	0.51 %
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89 %
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66 %
Të tjerë, refuzuan të deklarohen dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29 %
Gjithsej	1,739,825	100 %

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas të Kosovës): 5%.

Megjithatë, duke pasur parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet të shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të cilët janë marrë parasysh për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren parasysh këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas të Kosovës): 4%.

Përlllogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve në lidhje me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është vlerë e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga të anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërsa rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje/masë e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullsisë, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica e popullsisë.